

VENDIM
Nr.840, datë 3.12.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 114, DATË 31.1.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE, QË VENDDOSEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKETË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 23, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 114, datë 31.1.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “c”, e pikës 3, të kreut I, masa “500 (pesëqind) lekë” zëvendësohet me masën “1 000 (një mijë) lekë”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) Gratë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

dh) Viktimat e trafikimit/viktimat e mund-shme të trafikimit, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama